



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Nr./No. org. Org. jedinica Org. Unit	M-01-
Nr./No. i Faqeve Br. Stranica No. Pages	-02-
Nr./No. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	1600/21
Datum: Date:	17.03.21
PRISHTINË / A	
No. 1	

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

në mes të

**MINISTRISË SË MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE
INFRASTRUKTURËS**

dhe

ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Prishtinë
Mars 2025

Në mbështetje të nenit 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 Mars, 2019), nenit 11 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr.34/22 dt.18.11.2022), Shtojcës 1, pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit, kapitullit VI të Ligjit Nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, Statutin e Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës për Periudhën e Përkohshme me Nr. të Prot. 8648/24 të datës 31.12.2024, Rregulloren për Shumat e Kompensimit për Anëtarët e Organeve të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës me Nr. të Prot. 8658/24 të datës 31.12.2024, palët e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit:

1. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e përfaqësuar nga Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (në tekstin vijues MMPHI),

dhe

2. Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovë e përfaqësuar nga Kryetari i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (në tekstin vijues OIRK),

lidhin këtë:

MEMORANDUM TË MIRËKUPTIMIT

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit tani e tutje "Memorandumi" është të përcaktojë fushën e bashkëpunimit në ofrimin e mbështetjes financiare për OIRK-në gjatë periudhës së përkohshme të funksionimit të saj.

Neni 2

Parimet Themelore

Bashkëpunimi në mes MMPHI-së dhe OIRK-së bazohet në parimet e partneritetit, përgjegjësisë, transparencës dhe ligjshmërisë, komunikimit të ndërsjellët dhe ruajtjen e pavarësisë në mes të palëve.

Neni 3

Vlera e financimit dhe mënyra e Bashkëfinancimit

1. MMPHI financon funksionimin e OIRK-së në vlerë prej: 200,000.00 €, për vitin buxhetor 2025, nga Kodi buxhetor 50400 nga linja buxhetore Subvencionet dhe Transferet (Grantet Qeveritare).

2. Mjetet financiare në vlerë prej 200,000.00 € do të barten në xhirollogarinë me numër 1901093006041113 në bankën BKT në emër të OIRK-së.

3. Mjetet buxhetore do të shfrytëzohen sipas kategorive:

3.1. Paga dhe Mëditje në vlerë 108,920.00 €;

3.2. Mallra dhe Shërbime (Furnizimi me pajisje të IT, inventarizim, material shpenzuese dhe shërbime tjera), në vlerë 71,080.00 € dhe

3.3. Kompensimet tjera (shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit) 20,000.00 €.

5. Lejohet lëvizja e pozicioneve brenda kategorisë përkatëse, nëse do të jetë e nevojshme gjatë shpenzimit të buxhetit për atë kategori. Çdo lëvizje e këtyre pozicioneve të raportohet në MMPHI.

Neni 4 Obligimet e MMPHI-së

1. Mjetet për funksionimin dhe financimin e Odës gjatë periudhës se përkohshme do të barten tek OIRK në formë të grantit në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

2. Mjetet e dhëna në formë të grantit nga ana e MMPHI-së për OIRK-në, derdhen në llogarinë bankare të OIRK-së;

3. Detyrat dhe përgjegjësit tjera janë të përcaktuara në Ligjin Nr.08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, Statutin dhe Rregulloret tjera në fuqi të OIRK-së si dhe të gjitha dispozitat tjera ligjore relevante në fuqi.

Neni 5 Obligimet e OIRK

1. OIRK pajiset me numër fiskal nga Administrata Tatimore e Kosovës;

2. OIRK hap llogarinë bankare në emër të saj për pranimin e grantit;

3. Dorëzon Planin e Shpenzimeve për vitin përkatës buxhetor;

4. OIRK në baza mujore raporton për shpenzimet financiare;

5. Detyrat dhe përgjegjësit tjera janë të përcaktuara në Ligjin Nr.08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, Statutin dhe Rregulloret tjera në fuqi të OIRK-së si dhe të gjitha dispozitat tjera ligjore relevante në fuqi.

Neni 6 Personat Kontaktues

1. Të gjitha komunikimet në lidhje me këtë Memorandum si dhe të gjitha njoftimet do të bëhen me shkrim si në vijim:

1.1. Për MMPHI-në, Kryesues i Komisionit Ministror për Themelimin e Odës së Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, adresa: Ndërtesa e ish-Rilindjes, kati XIV, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, E-mail: licencimi.mmphi@rks-gov.net;

1.2. Për OIRK-në, , Kryetar i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, adresa: Kompleksi Rilindja, Kontejneri Nr.3, 10000 Prishtinë, Kosovë, E-mail: odaeinxhinierëve@gmail.com.

2. Dërgesa përmes emailit me një konfirmim të pranimit është e mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat e formës me shkrim.

3. Secila palë është e detyruar të njoftojë palën tjetër për çdo ndryshim në adresën postare ose të emailit për njoftime ose të personit të caktuar i kontaktit pa vonesa të panevojshme. Nëse kjo nuk ndodh, njoftimet do të konsiderohen ligjrisht të vlefshme në adresën e njoftuar më së fundi. Data e dërgimit (vula e postës ose konfirmimi me email) do të jetë e rëndësishme për marrjen në kohë të një njoftimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në këtë Memorandum;

Neni 7

Ndryshimi, plotësimi dhe ndërprerja e Memorandumit

1. Me pëlqimin paraprak të MMPHI-së dhe OIRK-së, ky Memorandum mund të ndryshohet dhe plotësohet.
2. Palët janë pajtuar në mes vete që ky Memorandum të zgjidhet me mirëkuptim.
3. Nëse brenda periudhës së perkohshme grumbullohen mjete të mjaftueshme nga të hyrat vetanake, MMPHI pas konsultimit me Odën, me vendim mund të ndërpret financimin nga Buxheti i Republikës së Kosovës me ç' rast Oda vazhdon veprimtarinë me vetëfinancim.
4. Palët mbajnë të drejtën e ndërprerjes të njëanshme të Memorandumi duke njoftuar me shkrim palën tjetër, në rast se konstatojnë se palët nuk i kanë përmbushur përgjegjësit e veta të dala nga ky Memorandum.

Neni 8

Dispozita Kalimtare

Kontrata aktuale në fuqi me titullin "Furnizim me Material për Nevojat e Konstituimit të Odës së Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit" me numër 210-24-3606-1-2-1/C264, do të shfrytëzohet nga OIRK deri në përfundimin e saj.

Neni 9

Hyrja në fuqi

1. Ky Memorandum përfshinë obligimet e palëve nënshkruese, të cilat zotohen se të njëjtin do ta zbatojnë me përpikëri dhe në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, ndërsa obligimet e palëve rrjedhin pas nënshkrimit të këtij Memorandumi dhe do të jetë i vlefshëm gjatë periudhës së perkohshme të funksionimit të OIRK-së.
2. Mjetet financiare të parapara në nenin 3 të këtij Memorandumi, barten në xhirollogarinë e Odës më së largu 30 ditë pas nënshkrimit të këtij Memorandumi.
3. Pjesë e këtij Memorandumi është Shtojca – Plani i Shpenzimeve për OIRK-në për vitin 2025.

Nënshkruar në Prishtinë më datë 17/03/2025 në dy kopje në origjinal, në gjuhën shqipe.

Liburn ALIU

Ministër
Ministria e Mjedisit, Planifikimit
Hapësinor dhe Infrastrukturës

Arsim RAPUCA

Kryetari i Odës së Inxhinierëve të
Republikës së Kosovës

Planifikimi i shpenzimeve për Odën e Inxhinierëve për vitin 2025

Kategoria: Paga dhe Mëditje						
Nr.	Emërtimi	Numri i personave	Mëditja (€) / Paga	Numri i takimeve në muaj	Muaj	Vlera totale (€)
1	Kryetari i Odës	1	1000	/	11	11,000.00
2	Bordi Drejtues	6	100	6	11	39,600.00
3	Komisioni Disiplinor	3	100	3	9	8,100.00
4	Komisioni i Ankesave	3	100	3	9	8,100.00
5	Drejtori Ekzekutiv	1	980	/	9	8,820.00
6	Zyrtar të Administratës	3	700	/	9	18,900.00
7	Grupe Punuese, Këshilla Profesional dhe grupe të ekspertëve, etj.	9	100	2	8	14,400.00
Total						EUR 108,920.00

Kategoria: Mallra dhe Shërbime (Furnizimi me pajisje të IT, inventarizim, material shpenzues dhe shërbime tjera)							
Nr.	Emërtimi i pozicioneve	Nr.	Emërtimi i artikullit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Totali
1	Furnizim me material shpenzues	1.1.	Letër A4	pako	10	30	300.00
		1.2.	Toner për printer	copë	5	80	400.00
		1.3.	Tjera	/	1	2000	2,000.00
Total							2,700.00
2	Furnizimi me pajisje të IT-së	2.1.	PC komplet	copë	5	1000	5,000.00
		2.2.	Laptop	copë	2	1000	2,000.00
		2.3.	Aparat fotokopjues	copë	1	800	800.00
		2.4.	TV Smart	copë	2	1000	2,000.00
		2.5.	Printer A4	cope	2	250	500.00
		2.6.	Tjera	copë	1	2000	2,000.00
Total							12,300.00
3	Inventarizimi i zyreve	3.1.	Tavolinë pune	copë	6	100	600.00
		3.2.	Tavolinë e takimeve	copë	4	700	2,800.00
		3.3.	Karrigë për zyre lëkure lëvizëse	copë	6	150	900.00
		3.4.	Karrigë statike	copë	30	50	1,500.00
		3.5.	Dollap	copë	6	200	1,200.00
		3.6.	Të tjera	/	1	2780	2,780.00
Total							9,780.00

4	Shërbimet tjera për nevoja të Odës	4.1.	Zhvillimi dhe dizajnimi i ueb faqes së Odës si dhe mirëmbajtja 3 vjeçare dhe dizajnimi i Llogos së Odës	/	1	15000	15,000.00
		4.2.	Organizimi i mbledhjeve të Kuvendit të Odës së Inxhinierëve	/	1	10000	10,000.00
		4.3.	Edukimi i vazhdueshëm	/	1	8800	8,800.00
		4.4.	Furnizimi me vula, licenca, kartela	/	1	6000	6,000.00
		4.5.	Anëtarësimi në Organizata Ndërkombëtare	/	2	1500	3,000.00
		4.6.	Dita Botërore e Inxhinierit dhe aktivitete të tjera	/	1	3500	3,500.00
Total							46,300.00
Subtotal							EUR 71,080.00

Kategoria: Kompensimet tjera (shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit)						
Nr.	Emërtimi	Numri i personave	Vlera për një udhëtim	Numri i udhëtimeve në vit	Netët e qëndrimit	Vlera totale (€)
1	Shpenzimet e udhëtimit	4	500	5	/	10,000.00
2	Akomodimi	4	150	5	2	6,000.00
3	Shpenzimet e ushqimit	4	100	5	2	4,000.00
Total						EUR 20,000.00

REKAPITULIMI I SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORISË		
Nr.	Kategoria	Totali sipas kategorisë
1	Paga dhe Mëditje	108,920.00
2	Mallra dhe Shërbime (Furnizimi me pajisje të IT, inventarizim, material shpenzues dhe shërbime tjera)	71,080.00
3	Kompensimet tjera (shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit)	20,000.00
TOTAL		EUR 200,000.00